



**METODOLOGJIA E
NGARKESAVE TË
OPERATORIT TË
SISTEMIT**

DT-KO-006

ver. 1.3

faqe 1 nga 12

**METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË
OPERATORIT TË SISTEMIT**

Maj 2013

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 2 nga 12</i>

Përmbajtja

1.0	HYRJE	3
1.1	Qëllimi	3
1.2	Fushëveprimi.....	3
1.3	Kërkesat ligjore dhe rregullative	3
1.4	Licencat.....	4
2.0	ARANZHIMET KONTRAKTUESE	4
3.0	BAZA PËR NGARKESA	5
3.1	Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit.....	5
3.2	Shërbimet e Operatorit të Sistemit	6
4.0	TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)	6
4.1	Përcaktimi i shumës së gjithmbarshme i të hyrave të lejuara	6
4.2	Alokimi i MAR për aktivitete.....	7
5.0	STRUKTURA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT.....	7
5.1	Tiparet kryesore.....	7
5.2	Baza e ngarkesave	8
5.3	Formulat dhe Shembulli ilustrues për llogaritjen e Ngarkesave të OS.....	8
5.4	Llojet e ngarkesave të OS	10
6.0	BLERJA E SHËRBIMEVE NDIHMËSE.....	10
7.0	PËRSHTATJA PËR TEJKALIM/MOSARRITJE TË KTHIMIT TË MAR	11
	SHTOJCA 1: Procesi i ndarjes së shpenzimeve.....	12

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 3 nga 12</i>

1.0 HYRJE

1.1 Qëllimi

Ky dokument përmban metodologjinë e shfrytëzuar nga KOSTT gjatë përcaktimit të ngarkesave dhe detyrimeve që Shfrytëzuesit i paguajnë për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit¹, në veçanti ngarkesave dhe detyrimeve për Operatorin e Sistemit (OS).

1.2 Fushëveprimi

Ky dokument mbulon:

1. Trajtimin dhe parimet e përcaktimit të ngarkesave për shërbime të Operatorit të Sistemit në rrjetin e transmisionit;
2. Përkufizimin e shërbimeve të Operatorit të Sistemit;
3. Alokimin e kostove për Operatorin e Sistemit;
4. Kalkulimin e ngarkesave të Operatorit të Sistemit.

Ky dokument nuk trajton mekanizmat për balancim të tregut të energjisë elektrike, ofertat për shitje dhe ofertat për blerje të energjisë në treg për balancimin e sistemit elektrik. Këto janë mbuluar me Dizajnin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEMD)² dhe me Rregullat e Tregut.

Rregullat e Tregut gjithashtu përcaktojnë rregullat e detajuara të cilat Operatori i Tregut do t'i aplikojë gjatë faturimit të detyrimeve për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, në pajtim me këtë metodologji.

1.3 Kërkesat ligjore dhe rregullative

Kjo Metodologji merr parasysh dhe u përmbahet kërkesave të parashtruara në:

- Ligjin për energjinë Nr 03/L-184
- Ligjin për energjinë elektrike Nr. 03/L-201;
- Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185;

Kjo Metodologji gjithashtu është përgatitur në pajtim me dokumentet vijuese:

¹ Shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit janë përkufizuar në Kodin e Rrjetit.

² Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike, i nxjerrë nga KOSTT-i dhe i ratifikuar nga ZRRE.

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 4 nga 12</i>

- Rregullën për vendosjen e çmimeve për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (Rregulla për çmimet e OST/OT) 2011;
- Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike 2011;
- Parimet e Përcaktimit të Ngarkesave në Transmision.

1.4 Licencat

KOSTT-i mban dy licenca të lëshuara nga ZRRE³:

- Licencën për Operatorin e Sistemit të Transmisionit, për të realizuar transmisionin e energjisë elektrike. Kjo licencë kërkon nga KOSTT që të sigurojë qasje jo diskriminuese në sistemin e transmisionit mes shfrytëzuesve të sistemit dhe klasave të shfrytëzuesve të sistemit; dhe
- Licencën për Operatorin e Tregut të Energjisë, përmes së cilës garanton dhe kryen menaxhimin ekonomik të sistemit të energjisë elektrike.

Në vijim janë paraqitur llojet e ngarkesave që KOSTT i aplikon për shërbimet e tij si Operator i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut:

- **Ngarkesat për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS).** Mënyra e përcaktimit të këtyre ngarkesave është vendosur me Metodologjinë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS)
- **Ngarkesat e Operatorit të Sistemit.** Mënyra e përcaktimit të këtyre ngarkesave është vendosur me këtë dokument.
- **Taksat e Kyçjes.** Mënyra e përcaktimit të këtyre taksave është e vendosur me Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit.

Ngarkesat që KOSTT i aplikon lidhur me aktivitetet e tij si Operator i Tregut janë:

- **Ngarkesat e Operatorit të Tregut.** Mënyra e përcaktimit të këtyre ngarkesave është vendosur me Metodologjinë e Ngarkesave të Operatorit të Tregut.

2.0 ARANZHIMET KONTRAKTUESE

Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji përcaktojnë kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji për konsumatorët si dhe detyrat dhe obligimet e ndërmarrjeve energjetike dhe konsumatorëve të tyre. Në të përshkruhen edhe parimet e

³ ZRRE është Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 5 nga 12</i>

përgjithshme të kyçjes dhe shfrytëzimit të sistemit të transmisionit, leximit, matjeve, faturimit dhe inkasimit, si dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë.

Neni 5, paragrafi 2.2 i Kapitullit II (Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji) kërkon nga të gjithë furnizuesit⁴ që të nënshkruajnë marrëveshjen për kyçje me OST-në, në emër të konsumatorëve të tyre. Marrëveshja për kyçje përfshin klauzola që kërkojnë nga furnizuesi që të jetë palë nënshkruese e Marrëveshjes Kornizë për Rregullat e Tregut apo Marrëveshjes për Aderim në Rregullat e Tregut, sipas rastit.

Sipas Rregullave të Tregut pagesa e detyrimeve ndaj KOSTT është e obliguar. Rregullat e Tregut përcaktojnë procedurat që duhet ndjekur në rast të kontesteve lidhur me detyrimet apo mos pagesën e tyre.

3.0 BAZA PËR NGARKESA

Rregulla për Vendosjen e Çmimeve për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut përbën bazën për caktimin e Të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) në çdo vit përkatës, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Parimet e Përcaktimit të Ngarkesave në Transmision.

Sipas nenit 15 (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së), MAR duhet të alokohet në çdo vit përkatës mes të hyrave që duhet të kthehen përmes ngarkesave TNUOS, ngarkesave të operatorit të sistemit dhe ngarkesave të operatorit të tregut, në pajtim me metodologjitë që sajohen nga të licencuarit. Sipas nenit 19 (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së), Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit duhet të miratohet nga Rregullatori.

Sipas nenit 20 (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së), OST/OS duhet të dorëzojë metodologjinë e ngarkesave për Operatorin e Sistemit dhe të gjitha amendamentet e mëvonshme të kësaj metodologjie tek Rregullatori së paku 30 ditë pune⁵ para datës së propozuar të hyrjes në fuqi të tyre.

3.1 Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit

Neni 5 i Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit kërkon nga KOSTT që të sigurojë qasje jo diskriminuese për të gjithë shfrytëzuesit e sistemit apo klasat e shfrytëzuesve të sistemit, në veçanti në favor të ndonjë vartësi apo aksionari të saj, si dhe të ofrojë shfrytëzuesve të sistemit informatat që atyre u nevojiten për të gëzuar qasje efikase në sistem.

Gjithashtu, gjatë caktimit të ngarkesave dhe taksave për kyçje dhe shfrytëzim të sistemit të transmisionit, KOSTT duhet të ofrojë sinjale adekuate dhe jo diskriminuese dhe të sigurojë se

⁴ Furnizues janë të gjitha palët që mbajnë licenca për furnizim të lëshuara nga ZRRE.

⁵ Ditë pune janë të gjitha ditët e javës që me ligjet e Kosovës konsiderohet të jenë ditë pune.

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 6 nga 12</i>

këto ngarkesa dhe taksa do të inkurajojnë konkurrencë në sektorin e energjisë dhe do të lehtësojë kyçjen e palëve të reja në treg; të njëjtat janë në pajtueshmëri me Rregullën e Çmimeve të OST/OT dhe Parimet e Përcaktimit të Ngarkesave në Transmision.

3.2 Shërbimet e Operatorit të Sistemit

Shërbimet e operatorit të sistemit janë të përcaktuara në Licencën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe në Ligjin për Energjinë Elektrike. Të njëjtat përfshijnë si në vijim:

- Planifikimin operativ të sistemit;
- Dispeçimin e gjenerimit;
- Krijimin dhe mbajtjen e standardeve të sigurisë së operimit;
- Prokurimin e rezervës dhe shërbimeve tjera ndihmëse për operimin e sistemit;
- Prokurimin e energjisë së nevojshme për të mbuluar humbjet e energjisë në sistemin e transmisionit;
- Menaxhimin e interkoneksioneve me shtete tjera dhe i importeve, eksporteve dhe tranzitit nëpër këta interkonektorë, përfshirë sajimin e rregullave për menaxhimin e kongestionit.

4.0 TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)

4.1 Përcaktimi i shumës së gjithmbarshme i të hyrave të lejuara

Të hyrat që KOSTT mund t'i fitojë në një vit përcaktohen nga ZRRE përmes procesit të shqyrtimit tarifar. Ky proces përbëhet nga një shqyrtim periodik dhe përshtatja e rregullt për qëllim të indeksimit të kostove dhe të ardhurave të lejuara dhe përshtatjeve në rast të tejkalimit apo mosarritjes së mbulimit të kostove (shih nenin 5 të Rregullës për çmimet e OST/OT-së)

Duke ndjekur procesin e shqyrtimit tarifar, ZRRE përcakton MAR për KOSTT për transmisionin e energjisë elektrike. Veç kësaj, KOSTT i lejohet të pranojë të Hyra Tjera nga burimet në vijim:

- **Grantet:** ZRRE merr parasysh të hyrat nga grantet në përlogaritjen e fitimit të lejuar. Asetet e financuara nga grantet nuk janë të përfshira në kthimin e lejuar
- **Të Hyrat nga kyçjet:** Asetet e kyçjes të financuara nga konsumatori nuk janë të përfshira në kthimin e lejuar prandaj dhe nuk sigurojnë fitim për KOSTT. Hollësitë e plota të trajtimit kontabël të fondeve të pranuar nga Taksat për kyçe janë të përfshira në pasqyrën e metodologjisë së taksës për kyçe.

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 7 nga 12</i>

• **Të Hyrat /Shpenzimet nga transiti:** aktualisht nuk ka të hyra/shpenzime nga transiti. MAR i siguron KOSTT të hyrat e nevojshme për ndërtimin dhe operimin e rrjetit, duke përfshirë asetet e shfrytëzuara për rrjedha të transitit. Në shqyrtimet e mëhershme tarifore, ZRRE ka cekur se do të përshtatë MAR të KOSTT- nga të hyrat neto nga rrjedhat e transitit. Meqë të hyrat/shpenzimet e transitit pritet të lëvizin vit pas viti, KOSTT propozon që në vitin 2013 të themelohet një llogari e veçantë për të hyrat/shpenzimet nga transiti dhe që raportet e këtyre llogarive të dorëzohen tek ZRRE. KOSTT propozon që rregullisht të diskutohet pozita neto e llogarive me ZRRE dhe të arrihet pajtimi për bartjen adekuate të të hyrave/shpenzimeve në MAR, ashtu që të minimizohen variacionet në ngarkesat për përdoruesit e sistemit duke lehtësuar të hyrat/shpenzimet e transitit të transferuara në MAR për një periudhë disavjeçare. Kreditë dhe debitë e fondeve të llogarisë së transitit do të çojnë në pagesa të kamatës/ngarkesa dhe është propozuar që këto shuma të kamatës të përfshihen në përshtatjet e MAR.

Kur të jenë në dispozicion para supozime më të sigurta për të hyrat/shpenzimet e transitit, KOSTT do të hartojë një mekanizëm të hollësishëm lehtësues në konsultim me ZRRE.

4.2 Alokimi i MAR për aktivitete

Faza e parë e përllogaritjes së Ngarkesave për përdoruesit është që të alokohet MAR i përcaktuar në shqyrtimin tarifor tek aktivitetet e veçanta të TNUOS, Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut. Shtojca 1 përshkruan këtë proces në hollësi.

Propozohet që të gjitha përshtatjet në MAR e gjithmbarshëm, të cilat janë bërë në Përshtatjet e Rregullta (përfshirë përshtatjet për rrjedhat e transitit) të aplikohen pro-rata në vlerat e MAR të përllogaritura për secilin aktivitet të veçantë, të përcaktuar në pajtueshmëri me procedurën për alokim të përshkruar si më lart.

5.0 STRUKTURA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT

5.1 Tiparet kryesore

Tiparet kryesore të strukturës së ngarkesave për transmisionin janë të përcaktuara në Parimet e Përcaktimit të Ngarkesave në Transmision.

Tiparet kryesore të ngarkesave të Operatorit të Sistemit janë:

- Ndarja e Ngarkesave në Transmision (neni 8 i Parimeve të Ngarkesave të Transmisionit)
 - KOSTT për shërbimet e Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit i realizon të hyrat nga ngarkesat, duke i alokuar ato 50% tek Prodhimi dhe 50% tek Kërkesa.

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 8 nga 12</i>

- Ngarkesat do duhej të përcaktohen asisoj që të mund të dallohen kostot e sigurimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të transmisionit për nivele të ndryshme të tensionit.
Sa u përket Ngarkesave ndaj OS, KOSTT konsideron se nuk ka arsye për aplikimin e ngarkesave varësisht nga niveli i tensionit në të cilin është bërë kyçja (400/220 kV apo 110 kV). Megjithatë, KOSTT konsideron se gjeneruesit që janë të kyçur në sistem të shpërndarjes nuk do duhej të bartin koston e humbjeve në transmision.

5.2 Baza e ngarkesave

Për të përcaktuar ngarkesat e OS të aplikueshme për shfrytëzues individualë, duhet të përcaktohet baza e ngarkesave. KOSTT konsideron se njësitë vijuese janë në pajtim me Parimet e Përcaktimit të Ngarkesave (ngarkesave) në Transmision:

- OST/OT do të kalkulojë ngarkesat për OS për çdo vit, para fillimit të vitit në fjalë, në pajtim me nenet 19 dhe 20 të Rregullës për Çmimet e OST/OT.
- Pas miratimit të ngarkesave nga ZRRE, KOSTT do t'i publikojë ngarkesat për OS.
- Ngarkesat do të paguhen për MWh dhe aplikohen për sasitë mujore të energjisë së matur. Kostot për të cilat ngarkesat janë kërkuar nuk ndërlidhen me lokacionin në sistemin e transmisionit.

Siç u theksua më sipër, KOSTT nuk e konsideron si adekuate ngarkimin e gjeneratorëve të kyçur në shpërndarje me shpenzimet për prokurimin e energjisë së nevojshme për t'i mbuluar humbjet e energjisë në sistemin e transmisionit. Rrjedhimisht, për gjeneruesit e tillë kalkulohej ngarkesa të veçanta të OS.

5.3 Formulatat dhe Shembulli ilustrues për llogaritjen e Ngarkesave të OS

Formula e Të Hyrave të Operatorit të Sistemit:

$$A = B + C + D$$

Formulat e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit:

$$T-OSp = (A - C - D) / 2 / (E + F) + (C + D) / 2 / E$$

$$T-OSpsh = (A - C - D) / 2 / (E+F)$$

$$T-OSf = A / 2 / G$$

Përshkrimi dhe njësia:

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 9 nga 12</i>

A – Të Hyrat për OS - €

B – Kostot e OS - €

C – Kosto për Humbjet në Transmision - €

D – Kosto për Shërbimet Ndihmëse - €

E – Prodhimi i Kyçur në Transmision – GWh

F – Prodhimi i Kyçur në Shpërndarje – GWh

G – Kërkesa e Kyçur në Transmision – GWh

T-OSp – Ngarkesa e OS për Prodhuesin - €/MWh

T-OSpsh – Ngarkesa e OS për Prodhuesit e Kyçur në Shpërndarje – €/MWh

T-OSf – Ngarkesa e OS për Furnizuesin - €/MWh

Shembulli ilustrues:

A = 5,963,000 €

B = 2,363,000 €

C = 2,600,000 €

D = 1,000,000 €

E = 4,635,000 MWh

F = 200,000 MWh

G = 5,482,000 MWh

$$\mathbf{A = B + C + D = 2,363,000 + 2,600,000 + 1,000,000 = 5,963,000 \text{ €}}$$

$$\begin{aligned} \mathbf{T-OSp} &= (\mathbf{A - C - D}) / 2 / (\mathbf{E + F}) + (\mathbf{C + D}) / 2 / \mathbf{E} = \\ &= (5,963,000 - 2,600,000 - 1,000,000) / 2 / (4,635,000 + 200,000) + (2,600,000 + 1,000,000) / 2 / 4,635,000 = \\ &= 2,363,000 / 2 / 4,835,000 + 3,600,000 / 2 / 4,635,000 = \\ &= 0.24 + 0.39 = \\ &= \mathbf{0.63 \text{ €/MWh}} \end{aligned}$$

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
<i>ver. 1.3</i>		<i>fage 10 nga 12</i>

$$\begin{aligned}
 T-OSpsh &= (A - C - D) / 2 / (E+F) = (5,963,000 - 2,600,000 - 1,000,000) / 2 / (4,635,000 \\
 &\quad + 200,000) = \\
 &= 2,363,000 / 2 / 4,835,000 = \\
 &= \mathbf{0.24 \text{ €/MWh}}
 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
 T-OSf &= A / 2 / G = 5,963,000 / 2 / 5,482,000 = \\
 &= \mathbf{0.54 \text{ €/MWh}}
 \end{aligned}$$

Vërejtje: Vlerat e përdorura në këtë shembull janë vlera ilustrative dhe nuk përkojnë me vlerat e ndonjë viti të caktuar.

5.4 Llojet e ngarkesave të OS

Tabela në vijim paraqet njësitë e shfrytëzuara për caktimin e ngarkesave, të cilave u bëhet referencë në Rregullat e Tregut (sipas emrit dhe variablave) dhe njësitë matëse në këtë dokument me të cilat ato ndërlidhen.

Emri i ngarkesës në Metodologjinë e Ngarkesave të OS dhe Njësitë	Variabla në Rregullat e tregut	Emri i ngarkesës në Rregullat e tregut
Ngarkesa e OSp (për prodhuesin e kyçur në transmision) - MWh	TPOS	Ngarkesa e Prodhuesit për Operimin e Sistemit
Ngarkesa e OSpsh (për prodhuesin e kyçur në shpërndarje) - MWh	TPShOS	Ngarkesa e Prodhuesit në Shpërndarje për Operimin e Sistemit
Ngarkesa e OSf (për furnizuesin - kërkesa) - MWh	TFOS	Ngarkesa e furnizuesit për Operimin e Sistemit

6.0 BLERJA E SHËRBIMEVE NDIHMËSE

KOSTT është OST përgjegjës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse që janë të domosdoshme për operimin e sistemit të transmisionit. Shpenzimet e sigurimit të shërbimeve ndihmëse janë pjesë e funksionit të Operatorit të Sistemit dhe duhet të miratohen nga ZRRE.

Duhet theksuar se në vitet 2011/12 KEK sh.a. nuk i është bërë asnjë pagesë lidhur me shpenzimet ndihmëse, rrjedhimisht për shërbime ndihmëse ka pasur zero shpenzime. Nëse

	METODOLOGJIA E NGARKESAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	DT-KO-006
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 11 nga 12</i>

KOSTT fillon t'i bëjë pagesa KEK sh.a. apo ndonjë pale tjetër, në emër të blerjes së shërbimeve ndihmëse, kostoja e tyre do të duhet të përfshihet në kalkulimin e ngarkesave të Operatorit të Sistemit.

7.0 PËRSHTATJA PËR TEJKALIM/MOSARRITJE TË KTHIMIT TË MAR

Kjo metodologji e ngarkesave nuk merr parasysh në mënyrë eksplicite çfarëdo tejkalimi/mosarritje të MAR (apo elementeve të MAR të cilat i atribuohen aktiviteteve të OST/OT) në vitin relevant. Mekanizmi për përshtatjen e nën mbulimit apo mbi mbulimit të MAR është i përfshirë në kalkulimin e të hyrave maksimale të lejuara për vitin në fjalë, në bazë të përcaktimit në Rregullën e Çmimeve për OST/OT.

SHTOJCA 1: PROCESI I NDARJES SË SHPENZIMEVE

